



BASHKIM EUROPIAN - SHQIPËRI
KONKLuzionet e Përbashkëta të Takimit të Pestë
të Dialogut të Nivelit të Lartë për Prioritetet Kyçe



TIRANË, 24 MARS 2015

VENDI: HOTEL TIRANA INTERNATIONAL

- 1) Kryeministri Edi Rama dhe Komisioneri Johannes Hahn bashkëkryesuan takimin e pestë të Dialogut të Nivelit të Lartë (DNL) për Prioritetet Kyçe ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Europian, më 24 mars 2015. Në seancë plenare merrnin pjesë ministra të qeverisë, si edhe opozita e përfaqësuar nga kryetarja e Komisionit parlamentar për Integrimin Europian. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të institucioneve të pavarura.
- 2) Pjesëmarrësit në takim vunë në dukje vlerësimin e bërë në Progres-Raportin e KE-së për progresin e bërë nga Shqipëria në plotësimin e Prioriteteve Kyçe. Gjithashtu, gjykuan se sfidat përpara kërkojnë përpjekje thelbësore dhe të qëndrueshme nga ana e Shqipërisë. Komisioneri Hahn theksoi se konsolidimi i ritmit të reformave dhe arritja e rezultateve solide dhe të qëndrueshme në fushat që iu përkasin pesë prioriteteve kyçe janë përcaktuese për progresin në integrimin europian dhe do të shqyrtohen imtësisht prej BE-së.
- 3) Komisioneri Hahn nënvizoi se puna konstruktive në Kuvend ndërmjet qeverisë dhe opozitës është përcaktuese për qëndrueshmërinë e procesit të reformave të integritit. Ai theksoi rëndësinë e respektimit dhe zbatimit të rregullt të marrëveshjes politike të dhjetorit, me të cilën iu dha fund bojkotit parlamentar.
- 4) Komisioneri Hahn përshëndeti progresin e Shqipërisë me reformën në drejtësi, përfshi ngritjen e Komisionit të posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi. U ra dakord që Shqipëria do të informojmë Komisionin mbi punën dhe rezultatet e këtij komisioni. Për më tepër, Komisioneri nënvizoi se është e rëndësishme që procesi i reformave të jetë përfshirës, nën orientimet e Komisionit të Venecias. Ai theksoi se forcimi i pavarësisë, llogaridhënies dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë është vendimtar për një shtet ligjor të fortë dhe sidomos për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. U ra dakord që të finalizohet Strategjia për Reformën në Drejtësi 2014-2020 dhe të përshpejtohen përgatitjet për mbështetjen e mundshme buxhetore sektoriale.
- 5) Pjesëmarrësit në takim nënvizuan se Grupet e Përbashkëta të Punës (GPP) për Pesë Prioritet Kyçe zhvilluan takimin e dytë më 5 shkurt 2015, në Tiranë. Konkluzionet Operacionale të këtyre GPP-ve u miratuan si shtojcë integrale e këtyre konkluzioneve. Komisioneri Hahn nënvizoi rëndësinë e zbatimit të masave të evidentuara prej Grupeve të Përbashkëta të Punës dhe inkurajoi punën e mëtejshme sipas masave të përcaktuara në Udhërrëfyes.
- 6) Komisioneri Hahn përshëndeti progresin e Shqipërisë me reformën në administratën publike dhe me fillimin e zbatimit të Ligjit për Nëpunësin Civil, si dhe theksoi se

ndryshimet ligjore nuk duhet të minojnë objektivin për krijimin e një administrate publike me bazë merite dhe të depolitizuar. Në këtë kontekst, thelbësor është përmirësimi i mëtejshëm i grumbullimit dhe monitorimit të të dhënave. Gjithashtu, Shqipëria u nxit që të bëjë hapa para për miratimin në kohë të Kodit të Procedurave Administrative, si edhe me finalizimin e Strategjisë për Reformën e Administratës Publike 2015-2020.

- 7) Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e pavarësisë dhe funksionimit të duhur të institucioneve kyçe demokratike, si të parlamentit, gjyqësorit dhe autoriteteve rregullatore, si dhe institucioneve të tjera të pavarura. Ata rikujtuan se institucionet e pavarura luajnë rol kyç në funksion të përmbushjes së Kriterit Politik dhe të detyrimeve në kuadrin e *acquis* të BE-së. U ra dakord që Shqipëria të veprojë në bazë të konkluzioneve operationale, nga seminari mbi institucionet e pavarura të 3 shkurtit 2015, për të siguruar profesionalizmin dhe depolitizimin e institucioneve të pavarura, si edhe për të garantuar më shumë stabilitet në aspektin e kornizës së tyre ligjore dhe politikave të burimeve njerëzore.
- 8) Komisioneri Hahn përshëndeti angazhimin e Qeverisë shqiptare për të forcuar më tej luftën kundër korrupsionit, dhe në këtë drejtim, për të përfshirë rekomandimet e misionit të vlerësimit të Kornizës Anti-korrupsion në strategjinë dhe planet e veprimit anti-korrupsion.
- 9) Pjesëmarrësit mirëpritën angazhimin e Shqipërisë në luftën kundër trafikimit të drogës, si dhe rritjen e numrit të operacioneve për të identifikuar dhe çrrënjësuar kultivimin e narkotikëve. Ata theksuan se bashkëpunimi midis institucioneve të zbatimit të ligjit duhet të forcohet për të rritur efektivitetin e hetimeve.
- 10) Kryeministri Rama theksoi se angazhimi për Zgjerimin e BE-së kontribuon në modernizimin e Shqipërisë dhe sjell përfitime për të gjithë qytetarët shqiptarë. Në këtë drejtim, Shqipëria e konsideron vendimin për t'i dhënë statusin e vendit kandidat si një inkurajim për më shumë përpjekje të vendosura në procesin e reformave. Kryeministri Rama shprehu shpresën se vendimi për të kaluar në hapin tjetër, në hapjen e bisedimeve të anëtarësimit, do të merret nëpërmjet një procesi të besueshëm dhe të parashikueshëm, mbi bazën e përmbushjes së pesë prioritetëve kyçe.
- 11) Komisioneri Hahn nënvizoi gatishmërinë e Komisionit për të vazhduar mbështetjen e reformave që po bën Shqipëria me ekspertizë dhe ndihmë financiare. Në lidhje me alokimin e mundshëm të mbështetjes financiare të BE-së për dhënien e pajisjeve autoriteteve të zbatimit të ligjit, Komisioneri nënvizoi rëndësinë e shtimit më tej të përpjekjeve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kjo përfshin, *ndër të tjera*, heqjen e pengesave legislative ndaj hetimeve proaktive dhe eficiente, përmes ndryshimeve *ad hoc* të shënjestruara, përfshi ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale dhe shfrytëzimin me efektivitet të hetimeve financiare.
- 12) Kryeministri konfirmoi angazhimin e tij për një dialog konstruktiv dhe të qëndrueshëm politik ndërmjet qeverisë dhe opozitës, i cili është jetik për qëndrueshmërinë e procesit të reformave. Ai shtoi se krijimi i Këshillit Kombëtar për Integrimin Europian (KKIE), që do të kryesohet nga opozita, është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të përfshirjes së procesit të reformave lidhur me BE-në, dhe u angazhua për ta bërë funksional sa më parë .
- 13) Komisioni do të vazhdojë të japë asistencë dhe të monitorojë progresin për zbatimin e reformave në kuadër të Dialogut të Nivelit të Lartë dhe Grupe të përbashkëta të Punës mbi

prioritetet kyçe. Shqipëria do të raportojë mbi zbatimin e Udhërrëfyesit sipas afatit kohor dhe udhëzimeve të rëna dakord me Komisionin.

Shtojca: Konkluzionet e Grupeve të Përbashkëta të Punës mbi Prioritetet Kyçe, më 5 shkurt 2015.